



MINISTRIA E TURIZMIT,  
KULTURËS DHE SPORTIT  
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT  
DHE ANSAMBLIT POPULLOR

Nr. 433 Prot., datë 30.04.2026



UNIVERSITETI I ARTEVE

Nr. 920 Prot., datë 30.04.2026

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor**, me adresë sheshi “Skënderbej”, Pallati i Kulturës, Tiranë, me nr. NIPT-i K51717020W përfaqësuar në këtë marrëveshje nga Drejtori i Përgjithshëm, z. Aulon Naçi, më poshtë i referuar “**TKOBAP**”

dhe

**Universiteti i Arteve** me adresë bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë, me numër NIPT-i K51713024L, përfaqësuar në këtë marrëveshje nga Rektori, Prof. Dr. Erald Bakalli, më poshtë i referuar “**UART**”

Nënshkruesit e kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor (TKOBAP) dhe Universiteti i Arteve (UART) bien dakord për bashkëpunimin si më poshtë vijon:

*Duke pasur parasysh* objektin e veprimtarisë së palëve të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi,

*Të nxitur* nga dëshira për të zgjeruar dhe përmirësuar bashkëpunimin artistik, bazuar në interesin e përbashkët dhe me besimin e plotë që kjo marrëveshje do të krijojë mundësitë më të mira për të rinjtë që janë studentë pranë UART,

*Me qëllim* zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansamblit Popullor, Ministrisë së Kulturës dhe Universitetit të Arteve “Për implementimin e dokumentit “Pakti për Universitetin” lidhur më 3.10.2019,

*Duke marrë në konsideratë* forcimin e bashkëpunimit artistik dhe kulturor mes dy institucioneve,

*Duke vlerësuar* rëndësinë që kjo marrëveshje bashkëpunimi do të sjellë mes dy institucioneve, palët bien dakord që:



## NENI 1 QËLLIMI

Qëllimi i kësaj marrëveshje është krijimi i kushteve bashkëpunuese mes Universitetit të Arteve dhe TKOBAP për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me fokus të veçantë krijimin e hapësirave për promovimin dhe bashkëpunimin me të gjithë studentët e Universitetit të Arteve, sipas specifikave të programeve të studimit në UART dhe veprimtarive artistike të TKOBAP-së, për realizimin e praktikave profesionale/artistike dhe realizimin e përbashkët të veprave të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor sipas kushteve të përcaktuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

## NENI 2 BAZA LIGJORE

Kjo marrëveshje lidhet në mbështetje të ligjit nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 145, datë 10.3.2021 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Arteve si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në Republikën e Shqipërisë”, vendimit nr. 329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, vendimit nr. 41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar dhe shtojcat përkatëse, Udhëzimit nr. 29, datë 10.9.2018 “Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, Ministrisë së Kulturës dhe Universitetit të Arteve “Për implementimin e dokumentit “Pakti për Universitetin”, lidhur më 3.10.2019, Statutit të miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funksonimin e TKOBAP-së”, Statutit të UART, i ndryshuar.

## NENI 3 FORMAT E BASHKËPUNIMIT

1. Bashkëpunimi ndërmjet Palëve do të përfshijë, por pa u kufizuar në:

1.1. Formim dhe praktikë profesionale

- zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve të UART pranë TKOBAP;
- përfshirjen e studentëve në produksione artistike si asistentë, praktikantë apo interpretues;
- organizimin e masterclass-eve, leksioneve të hapura dhe punëtorive me artistë të TKOBAP.



- 1.2. Produksione artistike të përbashkëta
  - realizimin e shfaqjeve të përbashkëta (opera, balet, koncerte simfonike, projekte folklorike);
  - përfshirjen e pedagogëve dhe studentëve në projekte të repertorit të TKOBAP;
  - krijimin e një programi vjetor aktivitetesh të përbashkëta.
- 1.3. Kërkim shkencor dhe trashëgimi kulturore
  - projekte studimore mbi muzikën, baletin dhe folklorin shqiptar;
  - studimin e arkivave artistike të TKOBAP;
  - botime dhe aktivitete akademike të përbashkëta.
2. Kërkesat për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të UART-së në Teatrin Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor do të paraqiten me iniciativën e Universitetit të Arteve jo më vonë se data 31 Mars e çdo viti. Kohëzgjatja, programet që do të ndiqen, vlerësimi i studentëve dhe çdo çështje që lidhet me këto praktika do të vendoset me pëlqimin e të dyja palëve.
3. Pjesëmarrja e studentëve në aktivitetet e sezonit artistik të TKOBAP-së do të realizohet sipas kërkesave të TKOBAP-së. Kandidatët do të përzgjidhen nëpërmjet audicioneve nga një komision *ad hoc*, i përbërë nga dy përfaqësues të Universitetit të Arteve dhe tre përfaqësues të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor.
4. Studentët, të cilët janë diplomuar në nivelin Master të studimeve pranë UART-së me rezultatet më të larta, do të kenë mundësinë e pjesëmarrjes në koncerte për të cilat TKOBAP-ja do të ofrojë hollin e katit të dytë sipas një kalendari të dakordësuar mes palëve.
5. Personeli akademik i UART-së do të ketë mundësinë e zhvillimit të koncerteve të sezoneve të tyre artistike, të cilat do të përfshihen në Kalendarin Artistik të Teatrit Kombëtar të Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor, në hollin e katit të dytë sipas një kalendari të dakordësuar mes palëve.

#### NENI 4

#### ASPEKTET FINANCIARE

1. Kjo marrëveshje nuk krijon detyrime financiare të drejtpërdrejta ndërmjet Palëve.
2. Çdo aktivitet që përfshin aspekte financiare do të rregullohet me marrëveshje të veçanta nga Palët.

#### NENI 5

#### NDRYSHMI I MARRËVESHJES

Dispozitat e kësaj marrëveshje mund të ndryshohen me anë të pëlqimit të ndërsjellë me shkrim nga palët nënshkruese.

#### NENI 6

#### ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis palëve do të zgjidhet me marrëveshje midis tyre.



## NENI 7

### HYRJA NË FUQI DHE ZGJIDHJA E MARRËVESHJES

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj dhe është e vlefshme për një periudhë 5 (pesë) vjeçare me të drejtë rinovimi.
2. Kjo marrëveshje mund të zgjidhet para mbarimit të afatit të parashikuar:
  - me mirëkuptimin e palëve.
  - për arsye ligjore që bëjnë të pamundur vazhdimin e kësaj marrëveshje.
3. Për zgjidhjen e kësaj marrëveshje bashkëpunimi, secila nga palët nënshkruese mund të njoftojë palën tjetër me shkrim të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara dates së propozuar për ndërprerjen e marrëveshjes. Zgjidhja e marrëveshjes nuk mund të ketë efekt për aktivitetet/praktikat e dakordësuara më herët, përveç rasteve të forcave madhore.
4. Zgjidhja e marrëveshjes bëhet pa aplikuar penalitete të palëve ndaj njëra-tjetrës.

## NENI 8

### KOMUNIKIMET

Palët bien dakord se personat e autorizuar për ndjekjen dhe koordinimin për zbatimin e marrëveshjes do të jenë:

a) Për **TKOBAP** personi i kontaktit do të jetë:

Drejtori i Përgjithshëm i TKOBAP

Email: aulon.naci@tkob.gov.al

b) Për **UART** personi i kontaktit do të jetë:

Zëvendësrektori për Projektet

Email: zvrektor.proj@uart.edu.al

Kjo Marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje në gjuhën shqipe, nga të cilat 2 (dy) kopje për TKOBAP dhe 2 (dy) kopje për UART.

**PËR**

**TEATRIN KOMBËTAR TË OPERAS,  
BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR  
PËRFAQËSUAR NGA  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Z. Aulon Naci



**PËR**

**UNIVERSITETIN E ARTEVE  
PËRFAQËSUAR NGA REKTOR**

Prof. Dr. Eraldo Bakalli

